



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 2, datë 04/03/2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR  
NËNTOKËSOR PËR AMBALAZHIM NË RASTIN KUR  
PËRDORIMI ËSHTË PËR >150 SHISHE/ORË,  $\geq 1$  l/sek”,  
SHOQËRISË “AKULL” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat.

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar, subjektit “Akull” sh.p.k., me vendndodhje Bashkia Fushë Arrëz, Qarku Shkodër sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

- X=507682
- Y=4661493
- Z=688 m.m.n.d

Prurja e kërkuar:  $Q = 2 \text{ l/sek.}$

Vendndodhja e pikës së shfrytëzimit

- $X=505840.5$
- $Y=4661261$
- $Z=633 \text{ m.m.n.d}$

Vendndodhja e pikës së shkarkimit

- $X=505840$
- $Y=4661240$
- $Z=621 \text{ m.m.n.d}$

Prurja e kërkuar:  $Q = 1.4 \text{ l/sek.}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KBUMAT**  
**GJOKË JAKU**

